




Resurset Humane

Manuali i përdorimit - Regjistrimi

1 LLogaria

1.1 Regjistrimi në sistem

Hapi i parë për përdorimin e sistemit është krijimi i llogarisë. Klikojmë mbi tekstin “**Krijo llogari**” e paraqitur në fotografinë më poshtë.



The image shows a login interface titled "Kyçu". It features a form with two input fields: "Shenoni emrin" (Enter name) with a user icon and "Fjalëkalimi" (Password) with a lock icon. A blue "Login" button with a right-pointing arrow is positioned to the right of the password field. Below the form, there is a link "Krijo llogari" (Create account) highlighted with an orange border, and another link "Keni harruar fjalëkalimin?" (Forgot your password?). At the bottom, the copyright notice "© 2020 HRSM SH. All rights reserved" is visible.

Figura 1: Hapja e llogarisë

Pasi klikohet butoni, në ekran shfaqet forma për plotësimin e të dhënave personale. Lloji i përdoruesit zgjidhet Specializant në rastin e aplikimeve për specializantë (fotoja e mëposhtme), ndërsa në rastin e aplikimeve për licencim të bizneseve private, zgjedhet lloji Institucion privat (fotoja e dytë më poshtë). Të gjitha fushat janë obligative, pra duhet të plotësohen të gjitha fushat ashtu që procesi të vazhdojë. Në rastin e licencimit të ISH private, shkruhet numri i biznesit fillimisht, pastaj emri i biznesit dhe adresa e biznesit. Tek numri i letërnjoftimit, vendoset numri personal i themeluesit dhe shtypet butoni search, ashtu që shfaqen automatikisht emri dhe mbiemri i themeluesit. Pastaj shënohet email për qasje në sistem, passwordi për qasje si dhe passwordi i konfirmuar. Pasi klikojmë butonin **Regjistro**, shfaqet mesazhi nga sistemi nëse përdoruesit i është hapur llogaria me sukses. Përdoruesit i vjen një kod verifikues në emailin që e ka shënuar gjatë regjistrimit, ku atë kod verifikues e shënon në hapin e ardhshëm që shfaqet pas regjistrimit. Ky hap shfaqet vetëm një herë gjatë regjistrimit të përdoruesit. Nëse kodi shënohet siq vjen në email, atëherë përdoruesi transferohet në ballinë të sistemit.




Figura 2: Lajmërimi për krijimin e llogarisë

Krijo llogari

Lloji i përdoruesit *

Institucion privat OJQ Specializant

Numri i letërnjoftimit *

Emri *

Mbiemri *

Email *

Password *

Konfirmimi i password-it *

© 2020 HR. All rights reserved

Figura 3: Hapja e llogarisë për specializantë

Krijoi llogari

Lloji i përdoruesit *

Institucion privat OJQ Specializant

Numri i biznesit*

Numri i biznesit

Search

Emri *

Emri i biznesit/OJQ

Adresa *

Adresa e biznesit/OJQ

Numri i letërnjoftimit *

Numri personal

Search

Emri *



Mbiemri *



Email *



Password *

Password



Konfirmimi i password-it *

Retype password



Regjistroni



Figura 4: Hapja e llogarisë për licencim të ISH

1.2 Qasja

Përdoruesi qaset në sistem duke shënuar numrin e vet personal për specializantë, ndërsa në rastin e licencimit të institucioneve shëndetsore shënon numrin e biznesit në fushën ku shkruan *Shenoni emrin*, dhe passwordin e krijuar vet gjatë hapjes së llogarisë, pastaj klikojmë butonin **Login**

Kyçu

Shenoni emrin

1171276059

.....

Login

[Krijo llogari](#) [Keni harruar fjalekalimin?](#)

© 2020 HRSM SH. All rights reserved

Figura 4: Qasja

Në rast se keni harruar fjalëkalimin, klikoni mbi tekstin “**Keni harruar fjalekalimin?**” dhe ju shfaqet forma si më poshtë

Keni harruar fjalekalimin?

Shkruani e-mail-in qe jeni regjistruar per ta resetuar password-in.

Email

Log-In Dergo

Figura 5: Keni harruar fjalekalimin

Shënohet emili me të cilin jeni regjistruar klikojmë butonin **Dergo**, në email vie një link, klikojmë mbi linkun dhe shafqet forma për ndryshimin e fjalëkalimit.